



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

---

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738*

*E-mail: [rmuca@klsb.org.al](mailto:rmuca@klsb.org.al); Web-site: [www.klsb.org.al](http://www.klsb.org.al)*

Nr. 440/7 Prot.

Tiranë, më 31/12/2016

**V E N D I M**

*Nr. 182, Datë 31/12/2016*

**PËR**

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**  
**“PERFORMANCA E SHOQËRIVE PUBLIKE PËR ÇERTIFIKIMIN**  
**FINANCIAR”**

Në zbatim të planit vjetor, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI, etj.), sipas programit të auditimit nr. 440/2, date 06.09.2016 realizoi auditimin e performancës me temë “Performanca e Shoqërive Publike për Çertifikimin Financiar”. Ky auditim u programua për t’u ushtruar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, KESH SHA, OSHEE SHA, APD, UKT SHA, (OST) SHA, Albpetrol SHA, Posta Shqiptare SHA. Pas përfundimit të punës paraprake audituese u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. 440/3, datë 23.11.2016 iu dërgua projekt-raporti i auditimit Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, KESH SHA, OSHEE SHA, APD, UKT SHA, (OST)

SHA, Albpetrol SHA, Posta Shqiptare SHA. Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar dhe u morën parasysh të dhënat sipas pyetësorëve, shpjegimeve nga institucionet e përfshira në këtë auditim të cilat janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në Raport Auditimin.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përmbushje të funksionit të vet kushtetues, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI dhe praktikat më të mira audituese në Evropë e më gjerë, i orientuar drejt modernizimit dhe rritjes cilësore profesionale të kapaciteteve njerëzore, strukturore dhe teknike në të gjithë administratën publike, e ka vënë theksin gjithnjë e më tepër tek auditimi i performancës dhe roli këshillimor i tij.

Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës përbën një nga sfidat më madhore të strategjisë së KLSH. Nëpërmjet auditimeve të performancës vlerësohet nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara.

KLSH e ka përqendruar auditimin e performancës pikërisht dhe kryesisht në rezultate, po aq sa në procese, duke theksuar nevojën për ndryshim, si dhe për përmirësim të përgjegjshëm dhe të vazhdueshëm të menaxhimit publik.

Certifikimi i raportimit financiar është mjaft i rëndësishëm për procesin e vendim-marrjes nga ana e investitorëve dhe përdoruesve të tjerë të këtij informacioni. Certifikimi i pasqyrave financiare është detyrim që vjen nga ligji, por dhe një domosdoshmëri për të pasur transparencë dhe besueshmëri. Ky proces rregullohet me ligje, udhëzime dhe rregullore për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar. Shoqëritë publike detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese të cilët kanë dhe koston përkatëse për këtë shërbim.

Në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, caktimi i ekspertëve kontabël të autorizuar për certifikimin e pasqyrave financiare ose rivlerësime bëhet nga asambleja e ortakëve të shoqërisë, një zgjedhje normale pasi ortakët e shoqërisë përfaqësojnë kapitalin dhe mund të marrin çdo vendim në lidhje me shpenzimet e shoqërisë. Kjo mënyrë zbatohet dhe në shoqëritë aksionere me kapital publik, ku ekspertët kontabël caktohen nga përfaqësuesi ligjor i

ortakut të vetëm të shoqërisë, që është ministri i linjës. Në këto shoqëri çdo shërbim i nënshtrohet ligjit të prokurimit publik. Përjashtim bëjnë rivlerësimet e asetëve dhe certifikimi i pasqyrave financiare.

Ekonomia e vendit në këtë situatë delikate të ekonomisë botërore, sidomos asaj të Eurozonës, por edhe e gjithë shoqëria shqiptare kanë nevojë për sigurimin e shërbimeve publike nga përdorimi me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet i fondeve publike.

Në përfundim, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” :

### **K O N K L U D O V A:**

Roli i audituesve ligjorë është të certifikojnë pasqyrat financiare të kompanive, pra për t`ju dhënë palëve të interesuara si investitorëve dhe aksionerëve një opinion lidhur me saktësinë e llogarive të kompanive. Një komunitet i gjerë i njerëzve dhe institucioneve mbështeten në cilësinë e auditimit ligjor. Për këtë arsye, duke përmirësuar integritetin dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare, auditimi ligjor kontribuon në funksionimin e rregullt të tregjeve. Raportimi financiar pavarësisht sektorit, duhet të jetë jo vetëm i besueshëm por edhe i dobishëm për t`u shfrytëzuar nga përdoruesit.

Ndërmarrjet e biznesit të sektorit publik, por edhe agjencitë lokale e kombëtare, përgatitin pasqyrat financiare gjithashtu për qëllime të përgjithshme, pasi këto pasqyra përdoren nga ligjvënësit dhe departamentet qeveritare, investitorët vendas e të huaj, punonjësit, kreditorët, publiku i gjerë, por edhe nga përdorues të tjerë. Me qëllim që këta përdorues të marrin siguri të arsyeshme në lidhje me treguesit financiarë të entiteteve të sektorit publik, është e nevojshme që këto pasqyra t`i nënshtrohen auditimit, nëpërmjet të cilit merret një opinion i pavarur nëse ato janë përgatitur në rregull, dhe nëse pasqyrojnë realitetin, përfshirë këtu dhe zbatimin e ligjshmërisë për veprimtarinë financiare të entitetit që i ka hartuar. Objektivat për auditimin dhe

raportimin mbi pasqyrat financiare të ndërmarrjeve të biznesit të qeverisë janë të ngjashme me ato për entitetet e sektorit privat.

Entet e sektorit publik përdorin burime shtesë, kryesisht për të përmbushur një shumëllojshmëri shtesë objektivash të tjera shpesh me natyrë jofinanciare, siç mund të jenë objektivat sociale, mjedisore, etj., të cilat tejkalojnë kërkesat e zakonshme që lidhen me plotësimin e objektivave të tyre tregtare. Ndërsa deklaratat financiare të audituara mund të tregojnë në lidhje me pozitën financiare, rezultatet e operacioneve dhe ndryshimet në gjendjen financiare, këto pasqyra financiare, në vetvete, nuk mund të raportojnë në mënyrë të përshtatshme për rezultatet e aktiviteteve me natyrë jo tregtare. Gjatë kryerjes së këtij auditimi, jemi përpjekur t'i japim përgjigje pyetjes: *A kryhet me ekonomicitet certifikimi i pasqyrave financiare në shoqëritë publike?*, dhe në përfundim ka arritur në këtë **mesazh auditimi**:

**Procesi i certifikimit të pasqyrave financiare është i rëndësishëm për përdorimin e pasqyrave nga ana e investitorëve dhe përdoruesve të tjerë të këtij informacioni. Për të mirësuar cilësinë e auditimit dhe rritjen e rolit të raportit të auditimit në vendimmarrjen e shoqërive publike, duhet siguruar një përmirësim i transparencës në procedurat e auditimit. Procesi i caktimit të ekspertëve kontabël, bëhet në mënyrë arbitrare në mungesë të udhëzimeve dhe rregullave, pa transparencë dhe kritere të përcaktuara. Në të njëjtën mënyrë vazhdon dhe procesi i lidhjes së kontratës me ekspertët kontabël të autorizuar, ku tarifimi për shërbimin e kryer vendoset në mënyrë unilaterale nga ekspertët duke mos dhënë shënime shpjeguese të rëndësishme lidhur me kontributin në auditim, sa dhe nga kush partner auditimi është ofruar kontributi me qëllim që të përdoret pushteti motivues i tregut në nxitjen e cilësisë së auditimit përmes seriozitetit në angazhim, rritjen e transparencës së procedurave, honorarëve dhe efektivitetin e këtij shërbimi në këndvështrimin kosto/përfitim.**

***Nisur nga konkluzionet, gjetjet dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar një proces transparent dhe me ekonomicitet të certifikimit të pasqyrave financiare në shoqëritë aksionere me kapital publik:***

## V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin e Auditimit me temë “Performanca e Shoqërive Publike për Certifikimin Financiar” të ushtruar në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, KESH SHA, OSHEE SHA, APD, UKT SHA, (OST) SHA, Albpetrol SHA, Posta Shqiptare SHA.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

***Për pyetjen :** A është mënyra e zgjedhjes së audituesve ligjorë për certifikimin e pasqyrave financiare tek shoqëritë publike, në funksion të minimizimit të kostove pa e cënuar cilësinë?*

- Mënyra e përzgjedhjes së audituesve ligjorë për certifikimin e pasqyrave financiare nuk siguron efikasitet dhe garanci në shërbimet e marra për sa kohë konstatohet mungesa e kriterëve, transparencës dhe konkurrencës së hapur mbi të cilat përzgjidhen ekspertët, si dhe nuk është e dokumentuar mënyra e llogaritjes së vlerës së kontratave (kosto).

*Për këtë rekomandojmë:*

1. Ministrinë e linjës të marrin masa që në përcaktimin e audituesve ligjorë për certifikimin e pasqyrave financiare tek shoqëritë publike, në funksion të minimizimit të kostove pa e cënuar cilësinë duke rritur transparencën, duke vendosur kriterë profesionale të përdorin procedurat e prokurimit publik për të arritur përdorimin e fondeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.

2. Ministrinë e linjës të marrin masa që të përmirësojnë procedurat e përzgjedhjes së audituesve ligjorë nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore që përcaktojnë rregulla, kriterë të qarta dhe transparente, për certifikimin e pasqyrave financiare tek shoqëritë publike.

### ***Menjëherë***

***Për pyetjen:** A ekzistojnë rregullore, udhëzime, standarte në përzgjedhjen e audituesve ligjorë?*

- Procesi i përzgjedhjes së ekspertëve kontabël nuk kryhet në mënyrë të unifikuar nga shoqëritë publike për shkak të natyrës së ndryshme të statusit juridik dhe bazës ligjore me të cilën operojnë. Procesi i emërimit të ekspertëve kontabël kryhet me përzgjedhje nga Ministri që përfaqëson pronarin e aksioneve të shoqërisë publike, kur kjo e fundit

ka varësi Ministrie, ndërsa kur statusi i një institucioni ka personalitet të ndryshëm juridik procesi i përzgjedhjes së ekspertëve bëhet edhe nëpërmjet kontraktimit të tyre me prokurim publik ose me vendim të organeve drejtuese të entit. Nisur nga sa më lart përzgjedhja e audituesve ligjorë kryhet me dy standarde, dhe nuk ka një metodologji të unifikuar për këtë proces.

*Për këtë rekomandojmë:*

**3.** Ministrinë që përfaqësojnë pronarin e aksioneve të shoqërive publike dhe organet drejtuese të këtyre shoqërive, duhet të udhëzojnë dhe të nxisin shoqëritë publike në përputhje me statusin juridik dhe bazën ligjore me të cilën këto shoqëri operojnë, për kryerjen e procedurave të përzgjedhjes së audituesve ligjorë sipas një metodologjie të unifikuar që të mos dublojë kontratat e shërbimit të audituesve ligjorë në mënyrë që të rregullohet procesi i përzgjedhjes së ekspertëve kontabël të autorizuar për certifikimin e pasqyrave financiare.

***Vazhdimisht***

***Për pyetjen:*** *A ka një metodologji të unifikuar për tarifimin e ekspertimit?*

- Nga auditimi rezultoi se nuk ka një metodologji të unifikuar për tarifimin e ekspertëve kontabël të emëruar nga Ministri i linjës së shoqërisë publike dhe organet drejtuese dhe nuk dokumentohen negociatat që zhvillohen midis ekspertit kontabël (ofruesi i shërbimit) dhe shoqërisë publike (autoriteti kontraktor).

*Për këtë rekomandojmë:*

**4.** Ministri që përfaqëson pronarin e aksioneve të shoqërisë publike dhe organet drejtuese të marrin masa që për shoqëritë publike që ka në varësi të hartojë një metodologji të unifikuar për tarifimin e ekspertëve kontabël të emëruar.

**5.** Shoqëritë publike të marrin masa që në të ardhmen për çdo kontratë të lidhur me ekspertët kontabël të dokumentojnë çdo negociatë për arritjen e vlerës së kontratës së nënshkruar dhe orët e punës në proporcion me numrin e transaksioneve.

***Vazhdimisht***

***Për pyetjen:*** *A ka vendime, udhëzime, modele për caktimin e tarifave?*

-Nga auditimi konstatohet se nuk ka asnjë vendim apo udhëzim për caktimin e tarifave orare për kontraktimin e ekspertëve i cili të zbatohet në mënyrë të unifikuar si

për ekspertët kontabël të miratuar nga ministria e linjës edhe për kontratat e lidhura nëpërmjet procedurave të prokurimit.

*Për këtë rekomandojmë:*

6. Ministria që përfaqëson pronarin e aksioneve të shoqërisë publike dhe organet drejtuese të marrin masa që për shoqëritë publike që ka në varësi të nxjerrë udhëzime për caktimin e tarifave orare për kontraktimin e ekspertëve i cili të zbatohet në mënyrë të unifikuar si për ekspertët kontabël edhe për kontratat e lidhura nëpërmjet procedurave të prokurimit

***Vazhdimisht***

***Për pyetjen:*** A përcaktohen orët e punës në program, detajuar zërave të caktuar sipas një vlerësimi të argumentuar apo fiktiv ?

- Nga analizimi i pjesëve përbërëse të kontratave konstatohet se në përgjithësi të gjitha kontratat kanë një aneks (shtojcë), pjesë integrale të kontratës ku përshkruhet një skedul me rubrikat ku do të fokusohet auditimi dhe orët e punës së nevojshme për auditimin e këtij zëri. Në përgjithësi programi i punës nuk është i detajuar dhe vlerësimi nuk është i argumentuar në lidhje me numrin e orëve të planifikuar bazuar në numrin e transaksioneve të zhvilluara gjatë vitit fiskal, si dhe nuk është dokumentuar koha faktike e harxhuar për këtë shërbim(auditim).

*Për këtë rekomandojmë:*

7. Shoqëritë publike të marrin masa që në ardhmen në hartimin e specifikimeve të kontratave të shërbimit të ekspertizës kontabël me ekspertët e emëruar nga ministria e linjës të detajojnë dhe argumentojnë orët e angazhimit në misionin e auditimit.

***Vazhdimisht***

***Për pyetjen:*** A shfrytëzohen eksperiencat e mëparshme në auditim, duke i reflektuar ato në orët e punës për auditimet pasardhëse?

-Nga auditimi dhe analizimi i të dhënave të siguruar nga subjektet e audituara rezulton se:

Për OST SH.A, për kontratat e ekspertëve kontabël të emëruar nga ministri konstatohet se emrat e ekspertëve kontabël mbeten mbi 50% të grupit të ekspertëve të njëjtë nga viti 2010 – 2012 dhe të njëjtë nga 2013 – 2015, numri i orëve që pretendohen që do të harxhohen në çdo angazhim auditimi ngelet i pandryshuar.

Për KESH SH.A, për kontratat e ekspertëve kontabël të emëruar nga ministri konstatohet se emrat e ekspertëve kontabël mbeten mbi 50% të grupit të ekspertëve të njëjtë nga viti 2010 – 2012 dhe të njëjtë nga 2013 – 2015, numri i orëve që pretendohen që do të harxhohen në çdo angazhim auditimi është në rritje.

Për Posta Shqiptare SH.A për kontratat e ekspertëve kontabël të emëruar nga ministri konstatohet se emrat e ekspertëve kontabël janë të ndryshëm në vitet 2010, 2011, 2012, 2013 ndërsa në vitet 2014 dhe 2015 grupi i auditimit është i njëjtë në masën 75%. Numri i orëve që pretendohen që do të harxhohen në çdo angazhim auditimi është në rritje nga viti në vit.

Për Albpetrol SH.A, për kontratat e ekspertëve kontabël të emëruar nga ministri konstatohet se emrat e ekspertëve kontabël mbeten mbi 30% të grupit të ekspertëve të njëjtë nga viti 2010 – 2012 dhe të njëjtë nga 2013 – 2015, numri i orëve që pretendohen që do të harxhohen në çdo angazhim auditimi është në rritje.

Si konkluzion mund të themi se eksperiencia e mëparshme në auditim nuk është reflektuar në përlllogaritjen e orëve në auditimin pasardhës por orët vijnë duke u rritur pavarësisht nëse ka apo jo rritje të numrit të transaksioneve gjatë vitit fiskal.

*Për këtë rekomandojmë:*

**8.** Shoqëritë publike të marrin masa, të negociojnë për reduktimin e orëve të programit të punës së ekspertëve kontabël, në rastet kur këto ekspertë riemërohen duke marrë parasysh eksperiencën e mëparshme në auditimin e këtyre shoqërive.

***Vazhdimisht***

***Për pyetjen:*** A do të ishte më ekonomik kontraktimi i ekspertimit, nëse do të kryhej përmes procedurave të prokurimit publik ?

-Nga analizimi i llojeve të ekspertizave kontabël të kryera për pasqyrat financiare të të njëjtit vit rezulton se 3 nga subjektet e audituara, konkretisht OST SH.A, OSHEE SH.A dhe KESH SH.A, dublikojnë shpenzimet për auditimin financiar të pasqyrave vjetore pasi në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet financiare të huave të marra, këto shoqëri përveç auditimit vjetor nga auditues që emërohen nga ministri, kontraktojnë përmes procedurave të prokurimit ekspert të pranuar nga donatorët.

*Për këtë rekomandojmë:*



9. Shoqëritë publike OST SH.A, OSHEE SH.A dhe KESH SH.A, si dhe të gjitha shoqëritë publike që në të ardhmen mund të marrin hua nga donatorë të huaj, të marrin masa që të informojnë Ministrinë që përfaqëson pronarin e aksioneve të shoqërisë publike për detyrimet që rrjedhin në lidhje me auditimin financiar nga marrëveshjet e huave dhe të programojnë në programet ekonomike vetëm një auditim vjetor nga audituesit e jashtëm ndërkombëtar të kontraktuar nëpërmjet procedurave të prokurimit publik duke mos dubluar shpenzimet për këtë shërbim.

#### ***Vazhdimisht***

- Në shoqëritë publike emërimi i ekspertëve kontabël për certifikimin e pasqyrave financiare bëhet në mënyrë sistematike nga Ministria që përfaqëson pronarin e aksioneve të shoqërisë publike në fund të vitit fiskal që do të auditohet ose 3-mujorin e parë të vitit pasardhës. Bazuar në këtë fakt ekspertët kontabël shprehin rezerva në dhënien e opinionit për aspekte që ata nuk mund ti verifikonin në kohën e kryerjes së disa proceseve që kanë të bëjnë me aktivet e shoqërisë (inventarizim, nxjerrje jashtë përdorimit apo mbylljet e arkës, etj.). E njëjta situatë paraqitet edhe në rastet e kontraktimit me prokurim publik të ekspertëve kontabël ndërkombëtar.

*Për këtë rekomandojmë:*

10. Ministria që përfaqëson pronarin e aksioneve të shoqërisë publike, të krijojë kushtet e përshtatshme për caktimin brenda shtatorit të vitit fiskal (pavarësisht mënyrës së përzgjedhjes) së ekspertëve kontabël për certifikimin e pasqyrave financiare.

#### ***Vazhdimisht***

- Nga krahasimi me zgjedhje për disa vite i opinioneve të dhëna nga ekspertët kontabël të emëruar nga Ministria dhe ekspertëve kontabël të kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për shoqëritë që duplikojnë këtë shërbim rezulton se për shoqërinë KESH SH.A:

Për vitin 2010 opinionimi për pasqyrat financiare nga ekspertët e emëruar nga ministria ka qenë “me rezervë” duke u bazuar në tre arsye ndërsa opinionimi i dhënë nga kompania e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit është “refuzim opinionimi me theksim të çështjes”, për disa arsye ku bazohet dhënia e këtij opinionimi dhe midis tyre përfshihen edhe faktorët e mësipërm.

Për vitin 2011 opinionimi për pasqyrat financiare nga ekspertët e emëruar nga ministria ka qenë “me rezervë”, duke u bazuar në tre arsye ndërsa opinionimi i dhënë nga kompania e

kontraktuar përmes procedurave të prokurimit është “opinion i kualifikuar me theksim të çështjes”, për disa arsye ku përmenden 19 arsye ku bazohet dhënia e këtij opinionit dhe midis tyre përfshihen edhe e faktorët e mësipërm.

Për vitin 2013 opinionit për pasqyrat financiare nga ekspertët e emëruar nga ministria ka qenë “me rezervë”, për 5 arsye, ndërsa opinionit i dhënë nga kompania e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit është “opinion i kualifikuar me theksim të çështjes”, për disa arsye ku përmenden 13 arsye ku bazohet dhënia e këtij opinionit dhe midis tyre përfshihen edhe e faktorët e mësipërm.

Për OST SH.A

Për vitin 2010 opinionit për pasqyrat financiare nga ekspertët e emëruar nga Ministria ka qenë i pakualifikuar, me këtë shënim: “Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar nuk janë zbatuar për Aktivet Materiale Afatgjata lidhur me zhvlerësimin e tyre si dhe mos përfundimi i procedurave për zhvlerësimin e materialeve me qarkullim të ngadalshëm” ndërsa opinionit i dhënë nga kompania e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit është “refuzim opinionit”.

Për vitin 2011 opinionit për pasqyrat financiare nga ekspertët e emëruar nga ministria ka qenë i pakualifikuar, ndërsa nga audituesit e kontraktuar përmes procedurës së prokurimit opinionit mbi pasqyrat financiare është opinion i kualifikuar.

Për vitin 2015 opinionit për pasqyrat financiare nga ekspertët e emëruar nga ministria ka qenë i pakualifikuar ndërsa opinionit i dhënë nga kompania e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit është pakualifikuar me theksim të çështjes.

*Për këtë rekomandojmë:*

**11.** Ministria që përfaqëson pronarin e aksioneve të shoqërisë publike dhe organet drejtuese të marrin masa që të unifikojnë procedurat e përzgjedhjes së ekspertëve kontabël për auditimin e pasqyrave financiare, duke mos dubluar këtë shërbim me qëllim që të përdoret pushteti motivues i tregut në nxitjen e cilësisë së auditimit përmes seriozitetit në angazhim, rritjen e transparencës së procedurave, honorarëve dhe efektivitetin e këtij shërbimi në këndvështrimin kosto/përfitim.

**12.** Organet drejtuese të shoqërive publike të marrin masa për të analizuar raportet e auditimit të ekspertëve kontabël, opinionet dhe mangësitë e konstatuara për pasqyrat financiare si dhe kërkimin e shpjegimeve nga ekspertët kontabël me qëllim unifikimin e opinionit që do të përcillet tek ministria dhe donatorët.

### Për KESH SH.A

Nga krahasimi dhe analizimi i vlerave për pasqyrat financiar të të njëjtit vit rezulton se për vitin 2010 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 3,450,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 14,000,000 lekë me një diferencë prej 10,550,000 lekë ose 4.05 herë më e lartë.

Për vitin 2011 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 3,450,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 10,880,000 lekë me një diferencë prej 7,430,000 lekë ose 3.15 herë më e lartë.

Për vitin 2012 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 3,450,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 10,890,000 lekë me një diferencë prej 7,440,000 lekë ose 3.15 herë më e lartë.

Për vitin 2013 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 2,765,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 8,610,000 lekë me një diferencë prej 5,845,000 lekë ose 3.11 herë më e lartë. Në korrik të këtij viti nga shoqëria janë shkëputur 4 hidrocentrale (Shkopet, Ulëz dhe Bistrica 1 dhe 2) të cilat kanë qenë asete të shoqërisë dhe për pasojë vlera e auditimit krahasuar me vitin 2012 është ulur me 2,280,000 lekë ose me 20 % më e ulët.

Për vitin 2014 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 2,800,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 12,900,000 lekë me një diferencë prej 10,100,000 lekë ose 4.6 herë më e lartë. Krahasuar me vitin 2013 vlera e auditimit është rritur me 4,290,000 lekë ose 49.8 % më e lartë ndërkohë që gjatë këtij viti 4 asetet e saj të shitura në korrik 2013 nuk janë më pjesë e pasqyrave financiare.

Për vitin 2015 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 2,800,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 13,900,000 lekë me një diferencë prej 11,100,000 lekë ose 4.96 herë më e lartë.

Viti	Vlera e kontraktuar për ekspertët e miratuar nga Ministria	Vlera e kontraktuar për ekspertët me procedurë prokurimi	Diferenca	Herë më e lartë
2010	14,000,000	3,450,000	10,550,000	4.05
2011	10,880,000	3,450,000	7,430,000	3.15
2012	10,890,000	3,450,000	7,440,000	3.15
2013	8,610,000	2,765,000	5,845,000	3.11
2014	12,900,000	2,800,000	10,100,000	4.6
2015	13,900,000	2,800,000	11,100,000	4.96

#### -Për OST SH.A

Nga krahasimi dhe analizimi i vlerave për pasqyrat financiar të të njëjtit vit rezulton se për vitin 2010 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 2,250,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 3,700,000 lekë me një diferencë prej 1,450,000 lekë ose 1.64 herë më e lartë.

Për vitin 2011 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 900,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 4,800,000 lekë me një diferencë prej 3,700,000 lekë ose 5.11 herë më e lartë.

Për vitin 2012 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 1,150,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 4,800,000 lekë me një diferencë prej 3,650,000 lekë ose 4.17 herë më e lartë.

Për vitin 2013 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 1,645,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 4,800,000 lekë me një diferencë prej 3,155,000 lekë ose 2.92 herë më e lartë.

Për vitin 2014 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 1,645,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 4,800,000 lekë me një diferencë prej 3,155,000 lekë ose 2.92 herë më e lartë.

Për vitin 2015 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 1,890,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e miratuar e emëruar nga Ministri ka qenë 4,800,000 lekë me një diferencë prej 2,910,000 lekë ose 2.53 herë më e lartë.

Viti	Vlera e kontraktuar për ekspertët e miratuar nga Ministria	Vlera e kontraktuar për ekspertët me procedurë prokurimi	Diferenca	Herë më e lartë
2010	3,700,000	2,250,000	1,450,000	1.64
2011	4,800,000	900,000	3,700,000	5.11
2012	4,800,000	1,150,000	3,650,000	4.17
2013	4,800,000	1,645,000	3,155,000	2.92
2014	4,800,000	1,645,000	3,155,000	2.92
2015	4,800,000	1,890,000	2,910,000	2.53

#### -Për OSHEE SH.A

Nga krahasimi dhe analizimi i vlerave për pasqyrat financiar të të njëjtit vit rezulton se për vitin 2014 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 4,480,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e emëruar nga Ministri ka qenë 20,000,000 lekë me një diferencë prej 15,520,000 lekë ose 4.46 herë më e lartë.

Për vitin 2015 vlera e kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik për auditimin e pasqyrave financiare ka qenë 3,990,000 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare nga ekspertët e emëruar nga Ministri ka qenë 26,000,000 lekë me një diferencë prej 22,010,000 lekë ose 6.51 herë më e lartë.

Viti	Vlera e kontraktuar për ekspertët e miratuar nga Ministria	Vlera e kontraktuar për ekspertët me procedurë prokurimi	Diferenca	Herë më e lartë
2014	20,000,000	4,480,000	15,520,000	4.46
2015	26,000,000	3,990,000	22,010,000	6.51

*Për këtë rekomandojmë:*

**13.** Ministria e linjës si dhe organet drejtuese të shoqërive publike të marrin masa që shërbimin e ekspertizës financiare ta kontraktojnë përmes procedurave të prokurimit publik për kontratat e shërbimit, pasi vlerat e kontratave të ekspertëve të emëruar nga ministria (pa procedurë konkurrimi) varjojnë nga 1.64 në 6.51 herë më të larta se vlera

e kontratave të shërbimit të ekspertimit të kontraktuar përmes prokurimit publik (konkurrencë e hapur)

***Vazhdimisht***

- APD është i vetmi subjekt i cili nuk dublikon shpenzimet për shërbimin e auditimit si dhe e siguron këtë shërbim me kosto më të ulët, gjë që e siguron vetëm procedura e prokurimit. Por duke analizuar përlllogaritjen e fondit limit me vlerën e kontratës së lidhur rezulton se ka një diferencë të madhe ku vlera e kontraktuar është sa 20 – 46% të fondit limit.

*Për këtë rekomandojmë:*

**14.** APD të marrë masa që në përlllogaritjen e fondit limit të prokurimit të shërbimit të ekspertizës së pasqyrave financiare të përdori eksperiencat e mëparshme të kontratave të lidhura për shërbim.

***Vazhdimisht***

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**